

BIO E ANETAREVE TE KESHILLIT DREJTUES

KATHRYN SWINTEK

Kathryn Swintek, drejtuese në këshillin drejtues dhe udhëheqëse biznesi me një eksperiencë të gjerë ndërkombëtare në institucione financiare. Ajo është Partnere Drejtuese dhe anëtare e Komitetit të Investimeve në Fondin Golden Seeds 2, fond ky që investon në kompani të sapo-themeluara në SHBA te cilat drejtohen nga gra dhe operojnë në fushën e kujdesit shëndetësor, teknologjisë, SaaS dhe sektorit konsumator/ e-commerce.

Znj. Swintek është gjithashtu drejtuese në disa shoqëri: Strata Skin Sciences, (Kryetare e Komitetit të Kontrollit), në shoqërinë Turtle & Hughes, (Kryetare e Komitetit të Kontrollit), Open Road Integrated Media, Oculogica dhe Bergen Medical Products, dhe është Kryetare e Këshillit Drejtues të Bankës Amerikane të Investimeve me qendër në Shqipëri. Më parë Znj. Swintek ka qenë Drejtuese e shoqërisë C200 (www.c200.org) dhe e Forumit të Gruas në New York si edhe administratore në Kolegjin e Mt. St.Vincent. Ajo është drejtuese e kompanisë teatrale, fituese të shume çmimeve, MINT (NYC), anëtare e Këshillit Kombëtar të Shtypit Graywolf (Minneapolis) dhe anëtare e shoqërisë Gratë Drejtuese të Korporatave (WCD).

Znj. Swintek ka qenë drejtuese e lartë ekzekutive në sektorin e investimeve bankare në një nga grupet më të mëdha bankare ndërkombëtare, BNP Paribas, në New York dhe Londër. Gjatë eksperiencës 20 vjeçare me këtë grup, ajo ka mbuluar pozicione të larta drejtuese në disa njësi, duke përfshirë pozicionin e Drejtueses Ndërkombëtare në njësinë e High Yield Bond, Drejtuese e njësisë së Strukturimeve Financiare në SHBA, Drejtuese në njësinë për Amerikën Veriore në Leveraged Finance dhe bashkë-drejtuese në njësinë ndërkombëtare të Sponsor Coverage. Përpara BNP Paribas, ajo ka punuar në shoqërinë Irving Trust (sot BNY Mellon) si Oficere Bankare në njësinë e Lindjes së Mesme dhe Afrikës, përfaqësuese për Francën me qendër në Paris, si dhe Zv. Presidente e Lartë dhe Drejtore e Divizionit të Financave të Blerjeve.

Znj. Swintek është diplomuar në Ekonomiks në Kolegjin e MT. St. Vincent dhe ka një Master në Administrim Biznesi në Financë nga Universiteti i New York. Zotëron frëngjishten dhe ka shtetësi të dyfishtë, amerikane dhe franceze.

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al